

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Elbasan

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË
“NDIHMËS NË MASAZHERI”

Kodi: NM-2019

Miratoi:

DREJTOR

.....

Elbasan, 2019

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“NDIHMËS NË MASAZHERI”

(NM-2019)

I. Profili Profesional i ndihmës në masazheri.

a) Karakteristikat e ndihmës masazhierit

Ndihmës masazhierit është i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar apo i vetëpunësuar në qendra të ndryshme fizioterapie, në qendra që ofrojnë shërbime fizike dhe rehabilitimi.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, ndihmës masazhierit duhet të zotërojë njohuri profesionale që kanë të bëjnë me konceptet bazë, si dhe shprehi praktike që lidhen me veprimtarinë profesionale të ndihmës masazhierit.

Suksesi i ndihmës masazhierit është i lidhur ngushtë dhe me sjellje (qëndrime) të tilla si : gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkolike, korrektësia, disiplina etj, sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe të përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e ndihmës masazhierit

Profesioni i ndihmës masazhierit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për lëvizjen sistematike të duarve mbi sipërfaqen e trupit. Ai/ajo mund të punësohet në qendra fizioterapie, ambulance për mjekësi fizike dhe rehabilitimi, vendet natyrore për mjekim, banjat, hotele SPA por edhe në qendrat për shëndet dhe bukuri.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e masazhierit të kualifikuar. Ndjekja e shkollës së lartë çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e fizioterapistit. Për të zhvilluar aktivitet privat dhe për vetpunësim në fushën e ndihmës masazhier duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i veçantë i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale si ndihmës masazhier.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Ndhmës në masazheri”

Në përfundim të Kursit për ndihmës në masazheri, kursantët do të jenë të aftë të:

- konsultohen me klientët për porosinë e marra;
- parapërgatitin vendin e punës për fillimin e punës;
- përzgjedhin dhe përdorin mjetet dhe materialet e punës;
- Sistemojnë vendin e punës, mjetet, pajisjet, materialet dhe dokumentacionin përkatës në qendrën/sallonin përkatës;
- përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin e masazhimit;
- mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe mjedisin e punës;
- analizojnë veprimin fiziologjik të masazhit në organizëm;
- zbatojnë kushtet për realizimin e masazhit dhe përzgjedhë aparatet për masazh;
- kryejnë masazhin në pjesë të caktuara të trupit (kokë, qafë, kraharor, të barkut, ekstremitete të sipërme, shpinës dhe ekstremitete të poshtme);
- kryejnë masazhin në lloje të caktuara të sëmundjeve;
- zbatojnë teknikën bazë të masazhit;
- zbatojnë rregullat dhe kërkesat për masazh;

- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik, higjenës dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës;
- përdorin dokumentacion për masazhimin;
- zbatojnë standardet e profesionit të rrobaqepsisë;
- komunikojnë me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Ndihmës në masazheri”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Ndihmës në masazheri” duhet të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e mesëm.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Ndihmës në masazheri”

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Ndihmës në masazheri”

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e ndihmës masazhierit.	NM-01-2019	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndihmës masazhierit 2. Kursanti përshkruan kushtet e mjedisit për realizimin e masazhit 3. Kursanti përshkruan pajisjet, aparatet dhe materialet e punës së masazhimit 4. Kursanti përshkruan rregullat e etikës, të higjenës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.
2	Teknikat bazë të masazhit	NM-02-2019	100 orë mësimore Rekomandohet: 50% Teori 40% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veprimin fiziologjik të masazhit në organizëm. 2. Kursanti përshkruan ndarjet dhe teknikat themelore për aplikimin e masazhit 3. Kursanti realizon kombinimin e masazhit me procedura të tjera fizike
3	Masazhi për qëllime relaksuese	NM-03-2019	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e masazhit relaksues në pjesë të caktuara të trupit 2. Kursanti realizon masazhin relaksues në pjesë të ndryshme të trupit

4	Masazhi kurativ	NM-04-2019	170 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e masazhimeve sipas llojeve të caktuara të sëmundjeve. 2. Kursanti realizon masazhe sipas llojeve të caktuara të sëmundjeve.
----------	-----------------	-------------------	---	---

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Ndhmës në masazheri:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e ndihmës masazhierit”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E NDIHMËS MASAZHIERIT	NM-01-2019
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të masazhierit, dhe aparatet për masazh, kushtet për realizimin e masazhit, me rregullat e etikës, të higjenës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndihmës masazhierit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë historikun, qëllimin dhe rëndësinë e shërbimeve të masazhit për individin; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtarinë kryesore të punës së ndihmës masazhierit; - të përshkruajë mjedisin, mënyrën e organizimit, kushtet për realizimin e masazhit; - të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe aparatet që përdor masazhieri; - të përshkruajë proceset bazë të veprimtarisë së masazhierit; - të tregojë organizimin e punës në një qendër masazhimi; - të tregojë si organizohet grafiku i takimeve për shërbimet në një qendër masazhimi; - të përshkruajë dhe të shkruajë ndërtimin dhe mënyrën e plotësimit të bazës së të dhënave të klientit/pacientit; - të përshkruajë kërkesat profesionale për masazhierin; - të tregojë mundësitë e punësimit në profesionin e masazhierit; - të përshkruajë kuadrin ligjor të veprimtarisë së masazhierit; - të argumentojë kërkesat për liçencim për ushtrimin e veprimtarisë së masazhierit; - të sistemojë mjetet dhe vendin e punës. - të komunikojë me etikë profesionale - të zbatojë rregullat e higjinës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan kushtet e mjedisit për realizimin e masazhit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të argumentojë rëndësinë e mjedisit në një ambjent pune masazhimi;
- të organizojë dhe mirëmbajë mjedisin e punës;
- të argumentojë se si duhet të jenë kushtet (hapësira, temperatura e ambjentit), për të realizuar një masazh;
- të përshkruajë kushtet të cilat duhet të plotësojë ndihmës masazhisti për të kryer masazh masazh;
- të përshkruaj përgatitjen fizike të ndihmës masazhistit për realizimin e masazhit;;
- të zbatojë kërkesat e higjienës personale
- të përshkruaj kushtet fizike të cilat duhet të plotësojë klienti/pacienti për masazh
- të përshkruajë mjedisin e një qendre masazhimi;
- të organizojë dhe mirëmbajë mjedisin e punës së ndihmës masazhistit;
- të sistemojë dhe mirëmbajë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e higjinës, të sigursë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me lisë kontrolli.

RM 3 Kursanti përshkruan pajisjet, aparatet dhe materialet e punës së masazhimit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të argumentojë rëndësinë e veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së masazhimit;
- të përshkruajë dhe të dallojë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së masazhimit;
- të tregojë përzgjedhë mjetet dhe materialet e të tregojë përdorimet e tyre në punë;
- të përshkruajë dhe mirëmbajë veglat, mjetet dhe pajisjet e masazhistit;
- të dallojë dhe tregojë përdorimet e materialeve të punës në veprimtarinë e masazhiatit;
- të interpretojë udhëzimet e proktukteve që përdor masazhisti si material pune;
- të sistemojë dhe mirëmbajë materialet e punës së masazhierit
- të sistemojë dhe mirëmbajë vendin e punës.

- të komunikojë me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e higjinës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë qepjes;

Instrumente e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë;
- Vlerësimi me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti përshkruan rregullat e etikës, të higjenës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të argumentojë veçoritë e tipeve të ndryshme të klientëve/pacientëve;
- të dallojë tipet e sëmundjeve të ndryshme të pacientëve/klientëve
- të përshkruajë dhe zbatojë rregullat e higjenës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit ku punon;
- të përshkruajë dhe zbatojë rregullat e higjenës, sigurisë dhe mbrojtjes personale; dhe zbatojë rregullat e higjenës, sigurisë dhe mbrojtjes së pacientit/klientit gjatë punës;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes nga zjarri, nga rryma elektrike apo rreziqe të tjera;
- të tregojë dhe përdorë rutinë e ndihmës së shpejtë dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së parë për pacientin/klientin;
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjenës dhe të ruajtjes së mjedisit;

Instrumente e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë;
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së masazhimit. Rekomandohen vizita dhe praktika në biznes që kryejnë veprimtari të masazhimit.
- Instruktori i kursit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës së masazhit. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për të kryer shpjeguar proceset e veçorive të profesionit të ndihmës masazhierit, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e ndihmës masazhierit. Ata duhet të nxiten që të dikutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë fillimisht te mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive teorike dhe praktike që

	parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në ambjente masazhimi; - Komplet i veglave dhe pajisjet si lektrostimul, infraterapi, baltoterapi, ultrasound, elektroforez, lazerterapi, etj - Veshje, uniforma për ndihmës masazhierin dhe pacientin/klientin; - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Teknikat bazë të masazhit”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	TEKNIKAT BAZË TË MASAZHIT	NM-02-2019
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantë me veprimin fiziologjik të masazhit në organizëm, me ndarjet dhe teknikat themelore për aplikimin e tij dhe i aftëson të realizojnë kombinimin e masazhit me procedura të tjera fizike.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 50% Teori; 40% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e ndihmës masazhierit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veprimin fiziologjik të masazhit në organizëm. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë veprimet kryesore që shkakton masazhi në organizëm; - të shpjegojë veprimin e masazhit në lëkurë; - të shpjegojë veprimin e masazhit në muskuj; - të shpjegojë veprimin e masazhit në nyje; - të shpjegojë veprimin e masazhit në indin lidhor; - të shpjegojë veprimin e masazhit në eshtra; - të shpjegojë veprimin e masazhit në qarkullimin e gjakut; - të shpjegojë veprimin e gjakut në sistemin limfatik; - të shpjegojë veprimin e masazhit në sistemin nervor; - të shpjegojë veprimin e masazhit në sistemin respirator; - të shpjegojë veprimin e masazhit në sistemin digjektiv; - të shpjegojë veprimin e masazhit në sistemin urogjenital; - të komunikojë me etikë profesionale. - të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit; Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti përshkruan ndarjet dhe teknikat themelore për aplikimin e masazhit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e masazhit në trup; - të shpjegojë masazhin manual; - të shpjegojë masazhin nënujor; - të shpjegojë masazhin vibrativ; - të shpjegojë masazhin me shtypje të kombinuar; - të shpjegojë masazhin pneumomasazh;	

- të shpjegojë masazhin me ultrazë;
- të shpjegojë masazhin me ultrazë;
- të shpjegojë kriomasazhin;
- të analizojë aplikimet e masazhit klasik manual;
- të analizojë aplikimet e masazhit refleksiv i limfës;
- të analizojë drenazhin manual;
- të përgatisë klientin për trajtimin dhe masazhimin;
- të marrë informacion paraprak për klientin/pacientin;
- të analizojë llojin dhe gjëndjen e lëkurës dhe të muskulaturës së trupit të klientit/pacientit;
- të përzgjedhë teknikën e masazhit;
- të përzgjedhë produktet, veglat, mjetet dhe pajisjet për masazhimin e klientit/pacientit;
- të zbatojë kërkesat e higjenës personale, të klientëve/pacientëve dhe të mjeteve të punës;
- të realizojë teknikën e përkëdheljes në masazh;
- të realizojë teknikën e fërkimit në masazh;
- të realizojë teknikën e ndrydhjes në masazh;
- të realizojë teknikën e goditjes së lehtë-perkusioni;
- të realizojë teknikën e vibracionit në masazh;
- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjenës dhe të ruajtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti realizon kombinimin e masazhit me procedura të tjera fizike.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën e duhur për kryerjen e masazhit;
- të konsultohet dhe të marrë informacion paraprak nga pacienti/klienti;
- të analizojë dhe diagnostifikojë gjendjen e lëkurës ku do të kryhet masazhi;
- të përzgjedhë teknikën e masazhimit;
- të zbatojë kërkesat e higjenës personale, të klientëve/pacientëve dhe të mjeteve të punës;
- të përzgjedhë produktet, mjetet, veglat dhe pajisjet për masazhim;
- të analizojë dhe realizojë kombinimin e masazhit me hidroterapinë;
- të analizojë dhe realizojë masazhin me termoterapinë;
- të analizojë dhe realizojë masazhin me sonoterapinë;
- të analizojë dhe realizojë masazhin me kinezoterapinë;
- të analizojë dhe realizojë masazhin me elektroterapinë;
- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale.

- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëhdim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së masazhimit. Rekomandohen vizita dhe praktika në biznes që kryejnë veprimtari të masazhimit. - Instruktori i kursit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës së masazhimit . Atyre duhet tu jepen detyra të përshkruajnë rëndësinë e masazhit në organizëm, të përshkruajnë ndarjen dhe teknikat e masazhit dhe kombinimin e masazhit me procedura të tjera fizike, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në ambjente masazhi. - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës si si lektrostimul, infraterapi, baltoterapi, ultrasound, elektroforez, lazerterapi etj - Veshje, uniforma për ndihmës masazhierin dhe pacientin/klientin. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Masazhi për qëllime relaksuese”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MASAZHI PËR QËLLIME RELAKSUESE	NM-03-2019
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e masazhit relaksues në pjesë të caktuara të trupit, si dhe aftëson ata që të kryejnë masazhe në pjesë të ndryshme të trupit.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e ndihmës masazhierit” dhe “Teknikat bazë të masazhit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e masazhit relaksues në pjesë të caktuara të trupit Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e trajnimeve dhe masazhimeve në pjesë të caktuara të trupit - të përshkruajë llojet e trajnimeve të trupit dhe masazhet përkatëse; - të përshkruajë procedurat për masazhimin sipas pjesëve të caktuara që klienti/pacienti do kryejë në trup; - të tregojë produktet, veglat, pajisjet dhe materialet për masazhimin e trupit; - të për zgjedhë dhe tregojë përdorimet e produkteve të ndryshme që përdoren për masazhimin e pjesëve të caktuara të trupit; - të organizojë grafikun e takimeve dhe bazën e të dhënave të klientëve - të përshkruaj rregullat e hixhenës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedsit gjatë masazhimit të pjesëve të caktuara të trupit - të tregojë - të përshkruajë rregullat e sigurisë gjatë përdorimit të makinave mjeteve dhe paisjeve. - të komunikojë me etikë profesionale. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti realizon masazhin relaksues në pjesë të ndryshme të trupit Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të përgatisë vendin, mjetet e punës, pacientin/klientin për masazhimin e pjesëve të trupit;	

- të marrë informacion paraprak nga klienti/pacienti;
- të analizojë llojin dhe gjëndjen e lëkurës dhe të muskulaturës së trupit të klientit/pacientit;
- të përzgjedhë produktet,veglat, mjetet dhe pajisjet për masazhimin e trupit;
- të përzgjedhë procedurat për masazhimin përkatës sipas pjesëve të trupit që do masazhohet;
- të zbatojë kërkesat e higjenës personale, të klientëve/pacientëve dhe të mjeteve të punës
- të realizojë masazhin e kokës;
- të realizojë masazhin e qafës;
- të realizojë masazhin e kafazit të krahbarori;
- të realizojë masazhin e barkut;
- të realizojë masazhin e ekstremiteteve të sipërme;
- të realizojë masazhin e shpinës;
- të vendosë realizojë masazhin e ekstremiteteve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së masazhimit. Rekomandohen vizita dhe praktika në biznes që kryejnë veprimtari të masazhimit.
- Instruktori i kursit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës së masazhimit. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për masazhimin e pjesëve të ndryshme të trupit,, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës në ambjente masazhimi.
- Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për të kryer masazhimin e pjesëve të ndryshme të trupit.
- Veshje, uniforma për ndihmës masazhierin dhe pacientin/klientin.
- Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Masazhi kurativ”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MASAZHI KURATIV	NM-04-2019
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e masazhit në lloje të caktuara të sëmundjeve dhe i aftëson ata të kryejnë masazhe sipas llojeve të sëmundjeve.	
Kohëzgjatja e modulit	170 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e ndihmës masazhierit”, “Teknikat bazë të masazhit” dhe “Masazhi për qëllime relaksuese”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e masazhimeve sipas llojeve të caktuara të sëmundjeve. . Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e trajnimeve dhe masazhimeve në pjesë të caktuara të trupit; - të përshkruajë llojet e masazheve sipas sëmundjeve; - të tregojë produktet, veglat, pajisjet dhe materialet për masazhimin e trupit; - të për zgjedhë dhe tregojë përdorimet e produkteve të ndryshme që përdoren për masazhimin e pjesëve të caktuara të trupit; - të përshkruajë te cilat sëmundje reumatologjike aplikohet masazhi; - të përshkruajë fazat e masazhit pas amputimit; - të përshkruajë te cilat sëmundje pas traumës aplikohet masazhi; - të përshkruajë te cilat sëmundje reuralgjike aplikohet masazhi; - të organizojë grafikun e takimeve dhe bazën e të dhënave dhe bazëm e të dhënave të klientëve; - të përshkruaj rregullat e hixhenës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë masazhimit të pjesëve të caktuara të trupit; - të komunikojë me etikë profesionale - të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RM 2 Kursanti realizon masazhe sipas llojeve të caktuara të	

sëmundjeve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të marrë informacion paraprak nga klienti/pacienti;
- të analizojë llojin dhe gjëndjen e sëmundjes te pacienti;
- të përgatisë pacientin për masazhimin sipas sëmundjes së caktuar;
- të përzgjedhë produktet,veglat, mjetet dhe pajisjet për masazhimin e trupit;
- të përzgjedhë procedurat për masazhimin përkatës sipas pjesëve të trupit që do masazhohet;
- të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientëve/pacientëve dhe të mjeteve të punës;
- të realizojë masazhin e sëmundjes reumatologjike, të dhimbjes së qafës dhe të shpinës;
- të realizojë masazhin e sëmundjes reumatologjike , të lumboishialgjia;
- të realizojë masazhin e sëmundjes reumatologjike, të spondilitit ankilozues;
- të realizojë masazhin e sëmundjes reumatologjike, të sklerozës sistematike progressive (sklerodermia);
- të realizojë masazhin e sëmundjes reumatologjike, të miofibrozitis (fibromialgjia);
- të realizojë masazhin pas amputimit;
- të realizojë masazhin e sëmundjes pas traumës, të kontuzionit;
- të realizojë masazhin e sëmundjes pas traumës, të distorionit;
- të realizojë masazhin e sëmundjes pas traumës, të pëlkrërit
- të realizojë masazhin e sëmundjes pas traumës, të thyerja (fraktura);
- të realizojë masazhin e sëmundjes pas traumës, të plagët;
- të realizojë masazhin e sëmundjes pas traumës, bursitin kronik;
- të realizojë masazhin e sëmundjes neuralgjike, lëndimet e nervave periferik;
- të realizojë masazhin e sëmundjes neuralgjike, paraliza e fytyrës (nervin. facialis);
- të realizojë masazhin e sëmundjes neuralgjike, të dëmtimit të plexus brachialis;
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së masazhimit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të masazhimit. - Instruktori i kursit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës së masazhimit . Atyre duhet ti jepen detyra praktike për masazhimin e trupit sipas sëmundjeve, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në ambjente masazhimi. - Komplet i produkteve, materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për të kryer masazhimet e trupit sipas sëmundjeve; - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

